



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA

Nr. 295 Prot.

Lezhë, më 24.03.2026

URDHËR

Nr. 47, datë 24.03.2026

PËR


MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR PËR
PREFEKTIN E QARKUT LEZHË

Bazuar në nenin 8, shkronja “j”, neni 20, pika 1, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, të nenit 6 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe të urdhërit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 280, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për autoritetet publike”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit të transparencës të rishikuar për Prefektin e Qarkut Lezhë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Nënpunësi Eduard Marku ngarkohet të publikojë programin e Transparencës të rishikuar në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën “Transparenca” dhe të ngarkojë çdo informacion të nevojshëm në të, në bashkëpunim me operatorin e kontraktuar për mirëmbajtjen e faqes zyrtare web.
3. Përgjegjësat e Sektorëve, Nënprefekti Kurbin dhe Nënprefekti Mirditë ngarkohen që ti vënë në dispozicion nënpunësit Eduard Marku çdo informacion që duhet të bëhet publik pa kërkesë.
4. Ngarkohen nënpunësit e administratës së Prefektit të Qarkut Lezhë për zbatimin e këtij urdhëri.
5. Ngarkohet specialistja e arkiv/protokollit të njohë administratën me këtë urdhër.
6. Ndjek zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI
Taulant Malshi



Lidhja nr.1

Programi i Transparencës - Prefekti i Qarkut Lezhë

Përditësuar: 24/03/2026

Programi i Transparencës		
Rreth autoritetit	Kuadri ligjor rregullator dhe integrimi evropian	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi Prefektin e Qarkut Lezhë	Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të Prefektit të Qarkut Lezhë	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat
Shërbimet që ofrohen nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të Prefektit të Qarkut Lezhë	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga Prefekti i Qarkut Lezhë	Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

Prefekti i Qarkut Lezhë

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"), Autoriteti Publik (Prefekti i Qarkut Lezhë, në vijim "Prefekti") publikon Programin e Transparencës (në vijim "PT") sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri").

Informacioni në PT publikohet i përditësuar, në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit.

Në PT janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik pa kërkesë. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të Prefektit. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit, Prefekti vlerëson nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Prefekti.

Nëse Prefekti nuk ka/zotëron informacione pjesë përbërëse të PT, atëherë bën shënimin përkatës (psh: nuk ka informacion, nuk ofron shërbimin, etj.).

Programi i Rishikuar i Transparencës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, miratuar me urdhërin nr.47 datë 24.03.2026

Rreth autoritetit

- Struktura organizative/Organigrama
- Struktura e pagave
- Funkcionet dhe detyrat e Prefektit të Qarkut Lezhë
- CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të Prefektit të Qarkut Lezhë, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të Prefektit të Qarkut Lezhë për të marrë vendime
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e Prefektit të Qarkut Lezhë (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave – Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

Kuadri ligjor rregullator dhe integrimi evropian

Tekset e plota

- Legjislacion ndërkombëtar
- Legjislacion kombëtar
 - Ligji nr 107 2016 Për Prefektin e Qarkut
 - Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë
 - Ligji nr 139 2015 Për Vetëqeverisjen Vendore
 - Ligji nr 152 2013 Për Nëpunësin Civil
 - **Ligji nr 90 2012 Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore**
 - Ligji nr 10 296 2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
 - Ligji nr 119 2014 Për të Drejtën e Informimit
 - Ligji nr 9936 2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë
 - Ligji nr 115 2014 Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore
 - VKM 874 Për miratimin e Rregullave të Etikës në Administratën Publike
- Informacion mbi procesin e integrimit evropian
 - Dokumente strategjike për integrimin evropian (nuk ka informacion)
 - Raportime mbi zbatimin e detyrimeve në procesin e integrimit evropian (nuk ka informacion)
 - Raporte monitorimi, auditimi dhe vlerësimi nga ana e Komisionit Evropian (nuk ka informacion)
 - Dokumenta të tjera mbi procesin e integrimit evropian (nuk ka informacion)
- Akte nënligjore
 - Vendimi Nr.134 date 07.03.2003 "PËR VËRTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE"
 - VKM Nr.52 date 22.01.2025 "Për emërimin në detyrë të Prefektit të Qarkut Lezhë"
 - Urdhër nr.45 datë 13.08.2018 "Për emërimin në detyrë të Nënprefektit Kurbin"
 - Udhër nr.62 datë 07.10.2024 "Për emërimin në detyrë të Nënprefektit Mirditë"
 - Urdhëra të Prefektit të Qarkut Lezhë
 - Urdhër nr 8 për krijimin e Task Forcës – Vendore për zbatimin e planit kombëtar të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit
 - Urdhër nr 1 për ngritjen dhe funksionimin e KREDH për Qarkun Lezhë
 - Urdhër nr 55 për krijimin e Task Forcës – Vendore për garantimin e sigurisë në shkolla
 - Urdhër nr 60 për krijimin e Task Forcës – Vendore ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2025 për Qarkun Lezhë
 - Urdhër nr 100 për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Rajonal Antitrafikim për Qarkun Lezhë
 - Urdhër nr 130 për ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave
 - Verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Lezhë
 - Konfirmim vendimi të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore – Viti 2025
 - Konfirmim vendimi të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore – Viti 2026
- Rregullore
- Kodi i sjelljes
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit
- Strategji
- Raport vjetor
 - Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe që prek publikun

E drejta për tu informuar dhe
për tu ankuar

- **Koordinatori**
 - Eduard Marku
 - email: eduard.marku@prefektilezhe.gov.al
- **INSTITUCIONI**
- E-maili
 - prefekti.lezhe@mb.gov.al
- Tel
 - 0215 22202
- Adresa
 - Rr. "Frang Bardhi", Lagjia Skenderbej, (4501), Lezhë
- Orari
 - E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30
 - E premte: 08:00 – 14:00
- **Model kërkesë**
- **Model ankese**
- **Hapat qe ndiqen per ankese**

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi Prefektin e Qarkut Lezhë

- Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë (Prefekti i Qarkut Lezhë nuk ka Rezolutë)
- Planet strategjike të punës. (Nuk ka informacion)
- **Raporte monitorimi/auditimi (p.sh:KLSH)**
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhe
 - **Raport vjetor 2024.**
 - **Regjistri i riskut per 6 mujorin e dyte te vitit 2025**

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të Prefektit të Qarkut Lezhë

- **Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara**
- **Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset**
- Donacione, sponsorizime (Nuk ka informacion)
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara (Nuk ka informacion)

Shënim: Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2025
 - Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike i ndryshuar për vitin 2025
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
 - Realizimi i regjistrit të prokurimeve për vitin 2025
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

Shënim: Prefekti i Qarkut Lezhë nuk zhvillon procedura konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat.

Shërbimet që ofrohen nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

- Gjendja civile – Pranë Prefektit të Qarkut funksionon Zyra e Gjendjes Civile Arkivi Lezhe, Kurbin dhe Mirdite, nga e cila lëshohen certifikatat:
 - Certifikatë lindje nga akti *
 - Certifikatë martese nga akti *
 - Certifikatë vdekje nga akti *
 - Certifikatë gjendje familjare para vitit 1974 *

* Tarifa për lëshimin e Certifikatave është: në gjuhën shqipe 50 lekë, e përkthyer 200 lekë

V.O Shërbimi për qytetarët ofrohet online në Portalin E-Albania.

- **Vërtetim i certifikatave për jashtë shtetit**

Bazuar në VKM-në Nr.134, datë 07.03.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit", (ndryshuar me VKM-në Nr.727, datë 30.10.2003"), Prefekti i Qarkut Lezhë vërteton dokumentacionin e lëshuar nga NJVQV, me qëllim për t'u përdorur jashtë vendit. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet postës ose pranë zyrave të institucionit dhe është pa kosto.

* Shënim: Lëshim dokumentacioni/Leje/Licenca/Autorizime etj.

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP

- Njoftimi dhe konsultimi publik (Ligji) *
- Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi *
- Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve *
- Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes *
- Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Prefektit të Qarkut Lezhë *
- Emër mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike *

*Shënim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

- Lista e dokumenteve që administrohen nga Institucioni i prefektit të Qarkut Lezhë me afatet e ruajtjes
- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

- Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrimit të miratuar nga Komisioneri)
 - Regjistër i kërkesave dhe Përgjigjeve 2023
 - Regjistër i kërkesave dhe Përgjigjeve 2024
 - Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025
 - Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve Janar – Mars 2026

Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP

- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë *
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve *
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim *
- Procedura e ankimimit *
- Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet *

*Shënim: Prefekti i Qarkut Lezhë nuk e ofron këtë shërbim.

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP

- **Njoftime të ndryshme**
- **Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil**
- **Raporte**
- Publikime (nuk ka informacion)
- **Statistika**
- Projekte (nuk ka informacion)
- Bashkëpunime etj. (nuk ka informacion)

Shënim: Prefekti i Qarkut Lezhe vlerëson publikimin duke patur parasysh kërkesat që merr më shpesh.